



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIQUE KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO	AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS AUTORITÉT KOSOVA ZA KONKURENCIJU KOSOVO COMPETITION AUTHORITY
Nr.i Prot./Br. Prot./Prot.No. 138/16-02/12	1/3
Nr.i Fq./Br. St./No.Pg.	30.08.2016
Data/Datum/Date:	
PRISHTINË-PRISTINA-PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, mbeshtetje ne neni 28 (1.2), neni 29, paragrafi (1), neni 54, paragrafi (1.9), neni 3 paragrafi (1.8), neni 34, neni 35 paragrafi (5) i Ligjit per Mbrojtjen e Konkurrencës nr.03/L-229 datë: 07 Totor 2010, Gazeta Zyrtare nr.88/25 Nentor 2010, pas shqyrtimit te shqetesimit te Autoritetit Publik gjegjesisht te Kryetarit te Komunes se Podujeves te dates 30 Korrik 2016, me dyshimin per Marreveshje dhe praktike te bashkerenduar ndermjet grumbulluesve te "Mjedres" ne Komunen e Podujeves, Komisioni i Autoritetit Kosovar te Konkurrencës ne mbledhjen e mbajtur me daten 29.08.2016 mori kete:

KONKLUSION

- I. Nuk mund të konsiderohet treg relevant vetëm Komuna e Podujeves meqenëse prodhuesit dhe grumbulluesit kanë mundësi të shfrytëzojnë tërë hapsirën e Republikës se Kosovës.
- II. Gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun relevant, konstatojmë se nuk ka argumepte për "Fillimin e Procedurës Hetimore" në kuptim të dispozitave të këtij ligji.
- III. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës do të vazhdojë edhe më tutje monitorimin, analizimin dhe sjelljen e grumbullusve në treg që potencialisht mund të bëjnë shkelje të konkurrencës në kuptim të Nenit 4 të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës

ARSYETIM

Për të parë nëse ka kufizim të konkurrencës është analizuar jo vetëm ndikimi i sjelljes mbi konkurrencën nga ana e grumbulluesve, por edhe sitata e konkurrencës në treg.



Marrëveshjet/Praktikat e Bashkrënduara ndikojnë në rradhë të parë mbi veprimtarinë ekonomike të palëve duke kufizuar konkurrencën midis tyre.

Për të gjykuar mbi kufizimin e konkurrencës janë analizuar parametrat e konkurrencës në treg, si për shembull çmimi, sasia e prodhuar, cilësia e produkteve, varieteti i produkteve dhe inovimi në treg. Çmimi dhe sasia e prodhuar janë ndër parametrat më të rëndësishëm të konkurrencës, qdo kufizim i lirisë në caktimin e tyre nga ndërmarrjet është i dëmshëm për konkurrencën.

Analizat e monitorimit të sjelljeve të Grumbullusve të Mjedrës mbi konkurrencën, ka marrë parasysh kontekstin ekonomik duke filluar nga natyra e raporteve të tyre dhe duke vlerësuar më pas fuqinë e kombinuar të tregut të ndërmarrjeve pjesëmarrëse në tregun gjeografik të Kosovës, si dhe faktorë të tjera strukturorë siç janë përqëndrimi i tregut, stabiliteti i pjesëve të tregut në kohë, pengesat në hyrje dhe probabiliteti i hyrjes së ndërmarrjeve të tjera në treg (konkurenca potenciale).

Tregu i Monitoruar

Tregu përkates i shitjes, grumbullimit dhe përpunimit të pemëve të imëta, sektori i Mjedrës

Tregu relevant

- tregu gjeografik dhe
- tregu i produktit

Tregu gjeografik Autoriteti ka përcaktuar territori i Republikës se Kosovës.

Tregu i produktit është kultura bimore e kategorisë së frutave të buta – Mjedra

Varietet

Pollka

Miker

Villamet

Rritja e prodhimit është me rëndësi, por do të jetë afatshkurtër nëse nuk udhëhiqet nga produktiviteti dhe cilësia, ngritje e politikave prodhues/grumbullues nga institucionet gjegjëse. Grupi i Pemëve të Buta në Kosovë është në stadin fillestare në krahasim me vendet tjera.

Derisa, Kosova nuk do të jetë në gjendje të konkurrojë me Serbinë, Poloninë në sasi, ne mund të konkurrojmë në prodhimtari dhe shpejtësi të të mësuarit.

E rëndësishme është shprehja e vullnetit të përbashkët të palëve dhe dëshira që veprimi i kryer dhe sjellja e tyre, të mos ketë pasoja direkte ose indirekte mbi konkurrencën.

Më e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet praktikave të bashkërenditura që nuk janë të lejueshme dhe sjelljes paralele natyrale (parallel behaviour) të ndërmarrjeve në treg. Në rast se ndërmarrjet sillen në të njëjtën mënyrë duke ngritur paralelisht çmimet në treg, kjo nuk do të thotë, që kjo ngritje e çmimeve është rezultat i koordinimit të ndërmarrjeve. Kjo mund të vijë dhe si rezultat i një adaptimi natyral të konkurrentëve në treg, ose, për shembull, si reaksion i të njëjtës ngritje të çmimeve në tregun ndërkombtar. Ky lloj paraleлизmi nuk ndalohet nga ligji për konkurrencën.



Pas monitorimit, mbledhjes së të dhënave, vlerësimit dhe analizimit të Tregut Përkatës rekomandojmë si më poshtë:

Se

Ofertat e grumbulluesve janë reale, nuk janë të njëjta, eksporti është ai që e determinon çmimin, sepse 99% e produktit "Mqedër" eksportohet, rrijedhimisht edhe çmimet variojnë nga oferta dhe kërkesa në treg. Kështu që duke u bazuar në të dhënat e siguruar, konkludojmë se nuk ka te gjetura sa i përket shkeljes së Nenit 4 të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Andaj, për këtë rast dhe raste tjera të kësaj natyre, Autoriteti duhet që në mënyrë aktive të promovoje njohuritë për konkurrencën në treg, respektivisht të ngritë nivelin e vetëdijësimit dhe informimit për rolin e politikës së konkurrencës dhe njëherazi bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Këshilla Juridike:


Kundër ketij konkluzionit nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të inicoj konfliktin administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

Me këtë KONKLUZION të njoftohen:


- Arhiva
- Komuna e Podujevës – Kryetarit të Komunës z. Agim Veliu


**KOMISIONI I
AUTORITETI KOSOVAR TE KONKURENCËS**


Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar


Fatime Haziri
Anetare


Valon Prestreshi
Kryetar


Muhammed Krasniqi
Anëtar


Shaqir Morina
Anëtar



